



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria-Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/  
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science,  
Technology and Innovation*  
Kabineti i Ministres/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 01B/505  
Data: 07.12.2022

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të neneve 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06 / L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta zyrtare nr. 7/01 mars 2019), nenit 5 dhe nenit 13 paragrafi 13.1 të Ligjit nr. 02/L-67 për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik, neni 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4, shtojca 1 paragrafi 7 i Rregullores (QRK) nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive të datës 30.03. 2021, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Për hapjen e konkursit për tekste shkollore për klasat (I-V) dhe (VI-IX) në lëndët që kanë vetëm një tekst shkollor në përdorim**

1. Hapet konkursi për tekste shkollore për lëndët që kanë vetëm një tekst shkollor në përdorim për klasat (I-V) dhe (VI-IX):
  - 1.1. Faza e parë e konkursit realizohet për tekstet (I-V);
  - 1.2. Faza e dytë e konkursit realizohet për tekstet (VI-IX).
2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

**A r s y e t i m**

Këshilli i Ekspertëve për Programe dhe Tekste Shkollore (KEPTSH), më datën 01 dhjetor 2022, ka mbajtur takim lidhur me shqyrtimin e listës së teksteve shkollore, të cilat kanë të aprovuar vetëm nga një tekst shkollor në klasë dhe lëndë të ndryshme. KEPTSH, në mënyrë unanime ka propozuar që në secilën lëndë mësimore të ketë tekste alternative, mandej përmes shkresës me nr. të protokollit 3178 të datës 05.12.2022 i ka dorëzuar Ministres së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit rekomandimin për hapje të konkursit për tekstet shkollore, të cilat kanë të aprovuar vetëm nga një tekst shkollor në klasë dhe lëndë të ndryshme. Duke pasur parasysh këtë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Vendimi i dorëzohet:**

1. Grupit punues;
2. Kabinetit të Ministrit / MASHTI;
3. Zyrës së Sekretarit të përgjithshëm / MASHTI;
4. Departamentit për arsimin parauniversitar /MASHTI;
5. Arkivit /MASHTI.

Arbërie Nagavci

Ministre e MASHTI

